



Prona dhe Barazia Gjinore


PËRMIRËSIMI I QASJES NË TË DHËNA DHE PËRDORIMI
NË BALLKANIN PERËNDIMOR



8 MARS 2014

Përmirësimi i qasjes në të dhënat e zërthyerat gjinore (nga nga sistemet e IT-së për Administrim të të Dhënave) mund të ndikoj në përmirësimin e barazisë gjinore dhe ofrimin e mundësive për të ashtuquajturin 'Sektorin e tretë' të organizatave joqeveritare dhe lokale, veçanërisht ato që përfaqësojnë femrat. Udhëzuesit Standard¹ theksojnë që barazia gjinore është në thelb të të gjitha proceseve dhe aspekteve të qeverisjes për zotërimin e pronës, përfshirë formulimin e politikave, ofrimin e shërbimeve dhe qasjen në sistemet ligjore dhe informata.

¹ Udhëzuesit mbi Përgjegjësit e Qeverisjes së Zotërimit të Tokës, Peshkatarisë dhe Pyjeve në kontekstin e Sigurisë Kombëtare të Ushqimit



Udhëzuesi i cili është miratuar nga Komiteti i Sigurisë Botërore të Ushqimit (CFS) më 11 maj 2012 përcakton parimet dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht për praktikatat e përgjegjshme.



www.fao.org/nr/tenure/information-resources/en/

"Qeverisja e tokës për femra dhe meshkuj" është tani në dispozicion në gjuhën spanjolle dhe angleze

Ky Udhëzues Teknik përfshin studimin e rasteve, shembujve, listave kontrolluese dhe indikatorëve monitorues të sugjeruar për përmirësimin e barazisë gjinore në procese, institucione dhe aktivitete të përfshira në qeverisjen e zotërimit të tokës.



FRENGJISHT

SPANJOLLE

ANGLEZE

Programi më shumë se udhëheqësi (GTL)

Ballkanit Perëndimor



Objektivat kryesore:

Të avancohet barazia gjinore nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve për të gjeneruar të dhëna të zërthyerat gjinore nga sistemet e IT-së për Administrim të të Dhënave dhe për t'i përdorur ato si dëshmi të bazuara në hartimin e politikave.

Nga parimet në veprime

Pas miratimit të Udhëzuesit, FAO është duke punuar me partnerët e tij për të identifikuar zbrazëtit e mbështetjes së kaluar dhe për t'i këshilluar Qeveritë se si të mbushen këto zbrazëti.

FAO dhe Banka Botërore ekipi i tokës i EAQ-së janë duke punuar së bashku në integrimin e parimeve të barazisë gjinore në projektet e Administrimit të Tokës që janë duke u implementuar dhe në dizajnin e projektit të ri të Ballkanit Perëndimor.

Banka Botërore dhe mbështetja e FAO-së në EAQ

Aktualisht Banka Botërore është duke i financuar 16 projekte të administrimit të tokës në Europë dhe Azinë Qëndrore (EAQ) me një buxhet prej 645.32 milion USD dhe disa projekte të tjera në pritje për t'u implementuar. FAO është duke ofruar ekspertizë teknike në shumë fusha, duke përfshirë edhe Teknologjinë Informative. Pothuajse të gjitha vendet e EAQ-së kanë sisteme të IT-së së Administrimit të Tokës dhe ofrojnë të dhëna në formë digjitale (on-line). Ndryshimet në teknologji kanë kontribuar në qeverisje më të mirë të zotërimit të tokës në EAQ nëpërmjet shërbimeve të përmirësuara që nga efikasiteti, transparenca, mundësitë e limituara për korrupsion, llogaridhënia, qasja, barazia dhe perspektiva e shpenzimeve që i bënë këto shërbime më të përballeshme për të gjithë.

Nevoja për përmirësim të vazhdueshëm. Eksperienca në EAQ tregon që edhe pse institucionet që kanë të bëjnë me Tokën janë duke gjeneruar sasi shumë të mëdha të të dhënave, këto nuk janë duke u përdorur në mënyrë efektive për të informuar hartuesit e politikave, për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe fuqisë punëtore që t' i procesojnë në mënyrë të drejtë dhe t'i lidh ato ndërmjet nën-sektorëve dhe për çfarëdo periudhë kohore.

Udhëzuesit, seksioni 26 u bënë thirrje shteteve për implementim dhe i inkurajon ato që të formojnë platforma nga shumë akter dhe struktura në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal apo t'i përdorin platformat dhe strukturat ekzistuese.

Ky duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës, me pjesëmarrje, i ndjeshëm ndaj barazisë gjinore, i implementueshëm, me kosto efektive si dhe sistem i qëndrueshëm.

Më i madh se Leadershi (GTL)

Është siguruar trajnimi mbi parimet e Udhëzuesve dhe udhëzuesi teknik 'Qeverisja e tokës për femrat dhe meshkujt'; ekipet kanë zhvilluar plane vjetore dhe janë duke punuar në implementim.

Çështjet kryesore:

1. Të gjitha ekipet pjesëmarrëse në Programin e **GTL** kanë identifikuar mungesën e informimit dhe të interesimit të akterëve kryesor (p.sh. zyrtarët e lartë qeveritar, stafi i agjencive kadastrale, notaritë, përfshirë meshkujt dhe femrat) si një nga pengesat më të mëdha në arritjen e qëllimeve të tyre reformuese.
2. Ata kanë identifikuar mungesën e të dhënave të zbërthyer gjinore dhe mungesën e përkushtimit në studime si një pengesë tjetër shumë e madhe për të bindur akterët kryesor dhe për të udhëzuar në marrjen e vendimeve.

Të dy çështjet janë të lidhura ngushtë pasi që disponueshmëria e të dhënave të tilla është element kyç për të bindur të gjithë ata që nuk e shohin qasjen e femrave në të drejtat mbi pronën e paluajtshme si një çështje dhe prandaj nuk ka gjasa që tani për tani ta mbështesin ekzekutimin e propozimeve për reformim.

Informata gjinore janë mbledhur nga shumica e vendeve të EAQ-së, si pjesë e sistemeve të tyre të IT-së për Administrim të Tokës, por nuk janë hartuar apo nuk janë përdorur raporte mbi të dhënat e zbërthyer gjinore nga hartuesit e politikave në ato pak raste ku janë gjeneruar raporte të tilla.

Ekipet reformuese janë duke punuar së bashku

Përbërja e ekipeve:

- Hartuesit e politikave Qeveritare
- Ekspertët teknik
- Sektori privat - notaritë
- OJQ-të



Ballkani Perëndimor

Toka dhe Barazia Gjinore – Përmirësimi i qasjes në të dhëna dhe përdorimi i tyre në Ballkanin Perëndimor

Udhëzuesit, par 17.4 "... si pjesë e shkëmbimit më të gjerë të informacionit në publik, **regjistrat e të drejtave mbi zotërimin (pronën) duhet të jenë në dispozicion** tek agjencitë shtetërore dhe qeveritë lokale për të përmirësuar shërbimet e tyre. Informatat duhet të shkëmbehen në përputhje me standardet kombëtare, dhe **të përfshijnë të dhënat e zbërthyer mbi të drejtat e zotërimit.**"



Të dhënat e zbërthyer gjinore mund të merren nga sistemet e IT-së së Administrimit të Tokës

BURIMI I TË DHËNAV

Mbledhja e të dhënave gjinore si pjesë e aplikacioneve të palëve (përdoruesve) – në përputhje me LADM (ISO që nga 01 nëntori 2012).

Informatat gjinore janë në dispozicion si pjesë e të dhënave të tjera, të mbledhura nga agjencitë mbi tokën, siç është identifikuesi personal, numri i tatimit, numri i sigurisë shoqërore.

Lidhjen e regjistrave kyç të qeverisë

Përdorimi i emrave si identifikues gjinor²

LLOJI I RAPORTEVE

A. % e femrave të regjistruara në regjistrin pronësor (pronësi e plotë, bashkëpronësi, % e pronës së zotëruar)

B. % e femrave, që e kanë trashëguar prona/shitje-blerje/marrje e hipotekave

Të gjitha në nivel kombëtar, në nivel rajonal dhe lokal, përfshirë nivelin urban/rural me mundësi të përzgjedhjes së kohës që të demonstrohet dinamika dhe të lejohen analiza të efikasitetit të masave të implementuara të njëjës apo tjetrës.


² Gjinia mund të identifikohet nga shumica e emrave në regjistrin e tokës (Maria për shembull është emër femëror). Është bërë një test duke përdorur emrat më të popullarizuar nga regjistrat e tokës në Ballkanin Perëndimor. 2000 emra janë përzgjedhur nga regjistri i tokës, të cilët përfshijnë 96% të të gjithë regjistrave dhe nga të cilët mund të identifikohet gjinia në formë unike dhe me përdorimin e të dhënave raportet përkatëse janë gjeneruar. Kontrolli i kualitetit është realizuar për ato të dhëna që kanë pasur informata gjinore dhe ato prej nga emrat janë përdorur për ta identifikuar gjininë. Është vërtetuar që ka 100% lidhshmëri që emrat mund të jenë një burim i të dhënave gjinore. Kjo metodë mund të përdoret në vendet që nuk kanë informata gjinore.

Çfarë tregojnë të dhënat?


Full report Statistical data

Shqipëria

Femrat të cilat zotërojnë më pak se 25% pronës




Numri total i femrave pronare bazuar në të dhënat e vitit 2013




Republika e Kosovës³


Femrat të cilat zotërojnë më pak se 25% të pronës





Femrat, Meshkujt dhe të tjerët (kompanitë, toka e zotëruar shtetërore dhe komunale) përqindja e përgjithshme e pronësisë mbi pronën



Federata e Bosnjës




Femrat krahasuar me Meshkujt bazuar në zotërimin e përgjithshëm të pronës




Bosnja - Republika Srpska

Femrat të cilat zotërojnë më pak se 25% të pronës




Të dhënat Republikës Srpska




FRJ së Maqedonisë

Femrat të cilat zotërojnë më pak se 25% të pronës




Zotëruarit femra dhe meshkuj të pronës në Maqedoni




Mali i Zi

Harta e zotërimit




Përqindja e përgjithshme e femrave krahasuar me meshkujt si pronarë të pronave




Republika e Serbisë

Femrat të cilat zotërojnë më pak se 25% të pronës



Përqindja e përgjithshme e femrave krahasuar me meshkujt si



Të dhënat e zërthyera gjinore në Ballkanin Perëndimor tregojnë se megjithëse femrat dhe meshkujt kanë status të barabartë në ligj sa i përket pronës si dhe qasjes së barabartë në informata, prap se prap zakonet lokale, normat kulturore dhe traditat dominojnë mbi ligjet në disa vende dhe në mesin e disa grupeve. Prandaj nuk është e rrallë që femrat të humbasin të drejtat e tyre mbi pronën për shkak të të afërmeve meshkuj.

Udhëzuesit, par 9.7 "... aty ku reformat kushtetuese apo ligjore fuqizojnë të drejtat e fermave dhe i vënë ato në konflikt me zakonet, të gjithë akterët duhet të bashkëpunojnë që të përshtatin zakonet e tilla me sistemin e zotërimit të pronës."

³ Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Çfarë mund të bëjmë

DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E ZBËRTHYERA GJINORE



Përcaktimi i akterëve dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e barazisë gjinore

Përfitimet kryesore nga publikimi i të dhënave të zbërthyer gjinore:

Teknologjia e informacionit në sektorin e zotërimit të tokës mund ta rris përfshirjen e të ashtuquajturit 'Sektorit të tretë' në organizatat jo-qeveritare dhe lokale, duke i përfshirë edhe ato organizata që përfaqësojnë femrat.

Të dhënat mund të përdoren për të ngritur vetëdijen për përfitimet nga përmirësimi i barazisë gjinore në zotërimin e pronës së paluajtshme dhe të dhënat mund të shërbejnë si mjet i avancimit të inovacionit dhe investimeve për adresimin e dobësive në administrimin e tokës. Të dhënat e zbërthyer gjinore të lidhura më tej me të dhënat hapësinore tregojnë zonat më kritike gjeografike, ku duhet të përqendrohen më shumë përpjekjet.

Konkluzion

Një nga tetë parimet kryesore të implementimit të Udhëzuesit – **transparenca** – e definon se si komunikimi dhe ngritja e vetëdijes mund të mbështes një qeverisje të barabartë të pronës për të dy gjinitë.

Komunikimi dhe ngritja e vetëdijes janë thelbësore në ndryshimin e vlerave dhe qëndrimeve, përfshirë edhe ato për barazinë gjinore dhe zotërimin e qeverisjes së tokës. Komunikimi mund t'i mobilizoj njerëzit që të ndërmarrin veprime, siç është paraqitja e të drejtave të tyre mbi tokën, duke ndihmuar në ndërtimin e konsensusit mbi problemet dhe zgjidhjes së tyre të mundshme nëpërmjet pjesëmarrjes së të gjithë akterëve.

Avokimi i bazuar në dëshmi vërteton vlerën e procesit të barazisë gjinore, e cila me kontributin dhe pjesëmarrjen e të gjithë akterëve, si femra dhe meshkuj, e bënë të mundshme arritjen e një konsensusi dhe mbështetjen ndaj politikave që dalin nga kjo.

Sensibilizimi gjinor mund të duhet të integrohet në komunikim, ngritje të vetëdijes, përpjekje për avokim sepse qëndrimet që ekzistojnë gjatë rreth barazisë gjinore dhe tokës mund të jetë e vështirë të ndryshohen. Sensibilizimi i gjinor i efektshëm duhet të synoj si femrat dhe meshkujt e të gjitha moshave, feve, etnive, statusit shoqëror, etj.

Suksesi varet nga mbështetja politik-bërësve dhe zyrtarëve qeveritar. Strategjitë e komunikimit mund të fillojnë duke i sensibilizuar dhe trajnuar zyrtarët qeveritar dhe administratorët dhe teknikët e sektorit të tokës se si gjinia ka rëndësi dhe cilat janë përfitimet nga qeverisja e cila ofron mundësi të barabarta për të dy gjinitë në zotërimin e tokës.

Mesazhe të ndryshme nevojiten për audiencat të ndryshme. Si pjesë e mbledhjes së të dhënave, nëpërmjet një analize kualitative duhet të merret parasysh audiencat dhe të fokusohet në kuptimin e çështjeve nga këndvështrimi i tyre. Të vlerësohet niveli ekzistues i njohurive dhe i vetëdijes mbi dallimet gjinore sa i përket të drejtave pronësore (si të drejtave ligjore po ashtu edhe zakoneve) dhe sa i përket qasjes në shërbimet e regjistrimit të tokës.

Qasjet inovative të zbatuara për të dhënat e tokës dhe grafika mund rrisin qasjen e të dhënave relevante gjinore në nivel rajonal, kombëtar, lokal në një periudhë shumë të shkurtë kohore dhe me një kosto të ulët, duke theksuar zonat që kanë zbrazëti të vazhdueshme dhe duke krijuar mundësi për të definuar periudhën kohore për të monitoruar progresin dhe për të matur rezultatet e veprimeve të ndërmarrura.

LEXO MË SHUMË

"REALIZIMI I TË DREJTAVE NJERËZORE DHE BARAZIA NUK JANË ENDËRR, POR DETYRË E QEVERIVE, KOMBEVE TË BASHKUARA DHE E ÇDO QENIE NJERËZORE." BAN KI-MOON, SEKRETAR GJENERAL I KB

Buletini mbi qeverisjen e përgjegjshme të zotërimit të tokës
Regjistrohu në: VG-tenure@fao.org



Uebfaqja
www.fao.org/nr/tenure
www.worldbank.org

